



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

DREJTORIA TEKNIKE

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

Operatorit Ekonomik “NELSA” SHPK

Adresa: Tirane Dajt Lagjja Qesarak, Rruga Tirane-Dajt, Zona kadastrale 2460, me Nr.pasurie
199/32, Hyrja 1

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar** marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti III: **“Blerje mish, nënproduktet e tij dhe peshk”**, me Nr. **REF-13048-07-12-2024** për nevoja të Autoriteteve Kontraktore përfituese Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Tropojë dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e tretë do të bëhet nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore, në bazë të marrëveshjes kuadër.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 40 datë 22 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Operatori ekonomik “M.C.CATERING” sh.p.k**

NUIS K72218022J

Vlera e ofertës pa tvsh = **12,358,710** (dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “NELSA” sh.p.k**

NUIS J71601012S

Vlera e ofertës pa tvsh = **14,450,600** (katërbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “ARGENT DACI” pf**

NUIS L01914003T

Vlera e ofertës pa tvsh = **14,758,760** (katërbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit është s’kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “M.C.CATERING” sh.p.k**

NUIS K72218022J

Për arsyet e mëposhtme:

1. Në tabelën e paraqitur sipas pikës 7 e Kapacitetit Teknik të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, për artikullin **mish viçi**, operatori ekonomik ka deklaruar kontratë furnizimi me subjektin “FOGI” sh.p.k si prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi. Si rrjedhim KVO verifikoi në Regjistrin Kombëtar të Licensave, QKL on-line nga ku “FOGI” sh.p.k rezulton se **nuk disponon licensën e tregtimit të mishit** por është i pajisur me licensë nga QKL (Rritja ose tregtimit i kafshëve të gjalla dhe Nënkatëgoria: Mbarështrim i kafshëve në fermat agrolektorale të mëdha), subjekt i licensuar vetëm për tregtim të kafshëve të gjalla dhe nuk disponon asnjë licensë të vlefshme për therjen e mishit dhe tregtimit të tij. Mbështetur në këto fakte dhe dokumente, KVO vlerësoi në mënyrë shteruese se operatori ekonomik M.C.CATERING nuk plotëson kërkesat sipas pikës 7 të Kritereve të Veçanta për Kualifikim në lidhje me vërtetimin e furnizimit me mish viçi pasi operatori me të cilin ofertuesi ka lidhur kontratë furnizimi “FOGI” sh.p.k, nuk ka të drejta ligjore për shitjen dhe tregtimin e mishit por vetëm për shitjen dhe furnizimin e kafshëve të gjalla, dhe mbi këtë bazë oferta e këtij operatori ekonomik refuzohet.
2. Për artikujt: **a) mish i grirë viçi, b) kremviçe dhe c) proshutë viçi** operatori ekonomik ka deklaruar kontratë furnizimi me subjektin “Ismet Darsi” p.f si prodhues ose distributor i autorizuar nga prodhuesi. Në vijim KVO verifikoi në Regjistrin Kombëtar të Licensave, QKL on-line nga ku “Ismet Darsi” p.f rezulton me licensë nr. LN-3120-04-2017 “*Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)*” Si rrjedhim subjekti ISMET DARSİ nuk është prodhues i artikujve ushqimorë.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet**

një operator ekonomik fitues ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm i identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit është:

• **Operatori ekonomik “NELSA” sh.p.k**

NUIS J71601012S

Vlera e ofertës pa tvsh = **14,450,600** (*katërbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind*) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.